



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PERGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 838/11 prot.

Tiranë më 31.10.2022

VENDIM

Nr. 41, datë 31.10.2022

PËR KONTROLLUESIN “NOTER ALBANA SPAHIU”

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Noter Albana Spahiu” (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 139, datë 21.09.2022 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit me objekt:

- Verifikimi i ankesave të paraqitura pranë Zyrës së Komisionerit nga qytetari I. D dhe qytetari I.SH., në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është person fizik i licencuar nga Ministri i Drejtësisë për kryerjen e veprimtarisë noteriale sipas ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”.

Udhëzimi i përbashkët i hartuar nga Komisioneri dhe Ministri i Brendshëm, nr. 463, datë 10.12.2020 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin”, përcakton subjektet kontrolluese që kanë akses në

Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, në regjistrat themeltarë dhe në aktet e Gjendjes Civile. Sipas Aneksit 1, të bashkëlidhur këtij Udhëzimi, këtë akses e kanë edhe subjektet të cilët ushtrojnë veprimtari "Noteri" çka do të thotë se Kontrolluesi nëpërmjet sistemit e-Albania ofron shërbime të ndryshme për klientët. Gjatë shërbimit të ofruar për klientët, në cilësinë e Kontrolluesit mbledh dhe përpunon të dhëna personale të subjekteve të të dhënave.

2. Në kuadër të verifikimit të ankesave të paraqitur nga qytetari I.SH dhe qytetari I.D, nëpërmjet së cilave pretendojnë se, në datën 28.02.2022, janë njoftuar me një mesazh në platformën e-Albania në llogarinë e tyre se "*punonjësi Albana Spahiu i Dhomës Kombëtare të Noterëve ka gjeneruar dokumentin Certifikatë familjare*", për secilin, pa dijenin e tyre rezulton se, në Zyrën Noteriale është paraqitur qytetari M. B nëna e fëmijës së mitur A. I. SH dhe ka kërkuar të përgatiteshin disa deklarata prindi për kalim kufiri nga fëmija i mitur. Noteri pas kërkesës së nënës së fëmijës, ka aksesuar të dhënat e ankuesve përpara se palët të paraqiteshin dhe të firmosin aktin noterial, si dhe është parapërgatitur dokumentacioni për t'ju bashkangjitur aktit noterial.

Ankuesit në datë 06.05.2022 i janë drejtuar Zyrës Noteriale nëpërmjet komunikimit shkresor dhe atij verbal duke kërkuar informacion mbi qëllimin e përpunimit të të dhënave të tyre. Kontrolluesi iu ka dhënë shpjegime përse i përket arsyes përse është bërë kërkim në regjistrin online të gjendjes civile duke nxjerrë prej andej certifikatën familjare të tyre.

Nga verifikimi kryer rezulton se, Kontrolluesi ka aksesuar të dhënat personale të ankuesve bazuar në kartën e identitetit të I.SH dhe nr. Personal të I.D të cilat janë vendosur në dispozicion të noteres nga M.B duke vepruar në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret ligjore të përpunimit të të dhënave, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit.

Kontrolluesi ka shkarkuar certifikatat personale të ankuesve nga regjistri i gjendjes civile dhe ka përgatitur aktin noterial i cili nuk është formalizuar, pasi ankuesit nuk janë paraqitur për të kryer procedurën e sipërcituar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, ekzistenca e pëlqimit në këtë rast është e vetmja mundësi ligjore e kontrolluesit për të aksesuar/përpunuar të dhënat e ankuesve, referuar nenit 6 të Ligjit. Pëlqimi, në bazë të nenit 3 pika 24 të Ligjit, "*...duhet të jetë në formën e një deklaratë me shkrim, i dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij*".

Përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, të cilët nuk kanë dhënë pëlqimin paraprak dhe të shkruar për përpunimin e të dhënave të tyre, është në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë të sanksionuar në germën "a" të pikës 1 të nenit 5 dhe me kriterin ligjor të përpunimit të sanksionuar në germën "a" të pikës 1 të nenit 6 të Ligjit.

3. Në lidhje me zbatimin e detyrimeve të Ligjit, nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, si dhe nga hetimi administrativ i ushtruar rezultoi se Kontrolluesi nuk ka përmbushur detyrimin për “Njoftim” mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit ku citohet se “...Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim mbi përpunimin e të dhënave personale, është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe në realizimin e detyrimeve ligjore të këtij të fundit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre sipas Ligjit.

Kontrolluesi ka plotësuar, Formularin e Njoftimit në datë 17.10.2022, pas kryerjes së hetimit administrativ.

4. Kontrolluesi disponon një sistem video-survejsimi CCTV (një kamera) për mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme ku ushtron aktivitetin, për qëllim të sigurisë së dokumentacionit dhe ambienteve por, konstatohet se Kontrolluesi nuk informon subjektet e të dhënave mbi prezencën e sistemit të video-survejsimit (CCTV), në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr.3, datë 05.03.2010 të Komisionerit mbi “Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejsimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 3”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-survejsimit (CCTV) është i rëndësishëm, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mos përmbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vënë në dispozicion Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit, gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në datë 20.10.2022, ashtu si dhe në pretendimet me shkrim mbajti të njëjtin qëndrim, si vijon:

-Sa i përket pretendimit se, ...*Gjenerimi i Certifikatave nga portali e-Albania, kryhet me qëllim për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve...*,

Zyra e Komisionerit vlerëson se, është e rëndësishme që çdo Kontrollues (noter) të veprojë në përputhje me parashikimet e ligjit të posaçëm “për noterinë”, ligjit “për mbrojtjen e të dhënave personale” si dhe akteve nënligjorë në zbatim të tij. Në germën “b”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit parashikohet se, mbrojtja e të dhënave personale bazohet “në grumbullimin përpunimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime”. Në germën “ç”, të pikës 1, të nenit 6 të Ligjit parashikohet si kriter ligjor i përpunimit, të dhënat personale përpunohen vetëm “për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit”. Në referim të dispozitave të sipërcituara, kontrolluesit që ushtrojnë veprimtarinë në zbatim të ligjit “për noterinë” duhet të mos tejkalojnë qëllimin e përpunimit, sipas parashikimeve në ligjin e tyre të posaçëm.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit u shpreh se, pas kësaj ngjarje janë marrë masa të reja si:

- ✓ Në çdo akt noterial është inkorporuar dhënia e pëlqimit të palës pjesëmarrëse në Aktin noterial, me përmbajtjen:
Palët kanë ka dhënë pëlqimin, në kuptim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe për marrjen online të dokumentacionit certifikata nga portali shtetëtor e-albania. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, unë Noter/ia deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.
- ✓ Në e-albania aksesohet vetëm pasi palët kanë nënshkruar në aktin noterial dhe vetëm për dokumentacion në funksion të plotësimit të dokumentacionit për aktin noterial.

- Sa i përket konstatimit në lidhje me informimin mbi prezencën e CCTV, Kontrolluesi argumenton se, kamerat në zyrë nuk janë në gjendje pune, janë të instaluar në gjendje fiktive, dhe nuk kanë memorie regjistrimi.

Zyra e Komisionerit, vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Procesverbali është konsultuar ndërmjet palëve, në prani të palëve, në ambientin e Kontrolluesit, i cili është shprehur se akses në regjistrimet, ka vetëm znj. Albana Spahiu.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germave “a”, “b” dhe “d” të pikës 1 të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- a) *kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II, “Përpunimi i të dhënave personale” dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*

- b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- c)
- d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin që, shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 18, 21, 22, 29, 30, 39, pika 1, germat "a", "b" dhe "d", si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit;
2. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 30.000 (tridhjetë mijë) Lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit;
3. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20.000 (njëzetë mijë) Lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit;
4. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr.3, të marrë masa konkrete, për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, për sa i përket tabelave informuese.
5. Kontrolluesi në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e "Njoftimit", në lidhje me ndryshimin e gjendjes së përpunimit të të dhënave personale për të cilat është përgjegjës;
6. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 4 më sipër;
 - (ii) vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikën 5 më sipër;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti;

7. Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;

8. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit;
9. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 31.10.2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi